



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË
KIBERNETIKE



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2017

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II" nr.3Tiranë;

Faqe web: www.cesk.gov.al E-mail: info@cesk.gov.al

Tel./Fax : 04 2221 039

Autoriteti Kombëtar për Cerifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ushtron veprimtarinë e tij, në zbatim të ligjit 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ligjit nr.107/ 2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” dhe ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”,si dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve të besuara dhe sigurisë kibernetike.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ka filluar veprimtarinë e tij në maj të 2017 dhe është krijuar nga bashkimi i dy institucioneve ekzistuese dhe përkatësisht Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) dhe Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

Me qëllim funksionimin e Autoritetit të ri të krijuar përsa më sipër, stafet përkatëse të dy institucioneve ekzistuese, janë angazhuar në hartimin e VKM 141, datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të veta, veprimtaria e të dy institucioneve së bashku është konkretizuar me realizime detyrash, si më poshtë:

1. Fushatë ndërgjegjësimi, për përdorimin e identifikimit dhe nënshkrimit elektronik, me qëllim përfitimin e shërbimeve publike online nga qytetarët, të shtrirë në nivel kombëtar.
2. Lehtësimi i procedurave të transferimit të shërbimit, nga OKSHB AKSHI tek një palë e tretë (FSDKSH), për të identifikuar saktë dhe pajisur subjektet e përdorimit të shërbimit eReceta (farmacistë dhe mjekë)
3. Fushatë ndërgjegjësimi në bashkëpunim me shkollat 9-vjeçare të kryeqytetit, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga përdorimi i internetit të pasigurt, në kuader të ditës ndërkombëtare të internetit të sigurt.
4. Monitorim i implementimit të dokumentit të politikave për sigurinë kibernetike 2015-2017 nga institucionet publike.

Nga fillimi i veprimtarisë në maj deri në dhjetor 2017, veprimtaria e AKCESK, në ushtrim të funksioneve të veta është mbështetur në:

1. Hartimi dhe miratimi i metodologjisë për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, për sektorin publik dhe privat, e mbështetur në standardet ndërkombëtare për sigurinë kibernetike.
2. Hartimi i bllokskemës në funksion të implementimit të metodologjisë për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II” nr.3Tiranë;

Faqe web: www.cesk.gov.al E-mail: info@cesk.gov.al

Tel./Fax : 04 2221 039

3. Bashkëndimi i punës me institucionet publike dhe private, për mbledhjen e informacionit për identifikimin e infrastrukturave sipas metodologjisë dhe bllokskemës më sipër dhe hartimi i projekt VKM “Për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”, si dhe përcjellja e paketës së plotë pranë Këshillit të Ministrave.
4. Bashkëpunim me universitetet për orientimin dhe nxitjen e studenteve në qasjen e tyre kundrejt fushës së sigurisë kibernetike. Organizimi i konkursit “Teknologjia që punëson”, lidhur me fushën e sigurisë kibernetike, në kuadër të javës së inovacionit.
5. Organizimi i “Albania Cyber Academy”, aktivitet 1 javor, në bashkëpunim me universitetin UBT-cert, Kosovë, në të cilin studentet më të mirë të degeve të ICT, u trajnuan në aftësi të veçanta në fushën e sigurisë kibernetike, nga ekspertë dhe profesorë të fushës dhe u pajisën me certifikata kualifikuese.
6. Hartimi i VKM nr. 495, datë 13.09.2017, “Për miratimin e rregullave dhe përfitimit të shërbimeve publike elektronike”
7. Inspektim në 26 zyra nga 70, të ALEAT, në rang vendi, për mbikëqyrjen e proceseve të identifikimit të saktë të aplikueseve dhe dorëzimit të mjeteve që përmbajnë certifikatat elektronike.
8. Inspektim periodik i ALEAT për mbikëqyrjen e veprimtarisë në tërësi, për përmbushjen e kritereve dhe specifikimeve teknike për lëshimin e certifikatave të kualifikuara
9. Inspektim periodik i AKSHI për mbikëqyrjen e veprimtarisë në tërësi, për përmbushjen e kritereve dhe specifikimeve teknike për lëshimin e certifikatave të kualifikuara
10. Indikatorë tregues të matshëm, për shërbimet e besuara të ofruara nga OKSHB-të dhe përdorimi i tyre gjatë vitit.

• Certifikata te kualifikuara per administraten,subjekte private, e-receta	3781
• Certifikata te kualifikuara per qytetaret	226192
• Identifikime elektronike nga qytetaret ne e-albania	295
• Transaksione identifikimi elektronik bankat e nivelit te dyte	16712
11. Përmbushje e detyrimeve ndaj NATO dhe OSCE, sipas angazhimeve të marra në nivel kombëtar, me cilësinë e institucionit koordinues dhe si pikë kontaktit për institucionet publike vendase dhe organizmat ndërkombëtarë.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II” nr.3Tiranë;

Faqe web: www.cesk.gov.al E-mail: info@cesk.gov.al

Tel./Fax : 04 2221 039